



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

Data __.12.2022

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Supervizion “Rikonstrukcion pjesor i rrjetit te ujesjellesit ne Bashkin Durrës”:

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT

Kodi CPV: 71247000-1 - Mbikëqyrja e punës së ndërtimi

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve/termave të referencës të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike (termat e referencës) dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimet të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”..

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,881,569.00 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e pesqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.

Afati i realizimit është 12 muaj/ 365 ditë

Afati i realizimit të mbikqyrjes së punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet.

Argumentim:

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës me objekt: **Supervizion “Rikonstruksion pjesor i rrjetit të ujesjellesit ne Bashkin Durrës”**

Mbështetur në Seksioni III “VEPRA INXHINIERIKE”

“Tabela shoqëruese e tarifave -”, *GRUPI TARIFOR III*

Kostoja e llogaritshme e veprës (preventivi i punimeve) ka vlerë 99,965,370.4 lekë pa t.v.sh.

- **Vlera maksimale e të gjithë shërbimit nga faza I-rë deri në të IX rezultoi:**

$$99,965,370 \times 9.411\% = 9,407,849 \text{ lekë pa tvsh}$$

Mbikqyrja zë **20 %** për rikonstruksionin të vlerës sipas tabelës Nr. 10, Neni 38.

Vlera e mbikqyrjes për objektin e mësipërm është:

Vlera maksimale **9,407,849 x 20 % = 1,881,569.00 lekë pa t.v.sh.**

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit 2.2

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si dhe në nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2019, 2020 dhe 2021** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kësaj procedure.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për MRRPP, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 . Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019, 2020 dhe 2021** të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të

ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi **për shërbime** të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se **20 % të vlerës** së fondit të limit të përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik **për përmbushjen me sukses të kontratës, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe faturave tatimore te shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetem fatura tatimore të shitjes **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë profesionale të vlefshme për mbikqyrjen dhe kolaudim te punimeve objekt i kontrates, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Licencë profesionale të shoqërisë për supervizion punimesh te vlefshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë si më poshtë ose ekuivalente te tyre:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

N.P-1-Punime gjurmimi në tokë.

N.P-4-Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista Aeroportuale.

N.P-5-Punime nentokesore, ura e vepra arti.

N.P-7-Ujesjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

N.S-1-Punime për prishjen e ndërtimeve.

N.S-2 -Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, etj.

N.S-18 -Punime topogjeodezike

Licensa duhet te jete leshuar sipas rregullave te VKM nr 759 date 12.11.2014 ‘‘Per licencimin profesional te individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’’ i ndryshuar me VKM nr 943 date 28.12.2016. Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi.

Argumentim:

- N.P. 1 (Punime gjermimi në tokë) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime gjermimi.
- N.P. 4 (punime ne rrugë, autostrada, mbikalime) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi nderhyrje ne infrastrukturen rrugore.
- NP-5 (Punime nëntokësore) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi intersektimet e rrugës kryesore me mikrotunel dhe duhet të kryen punime special duke ditur se këto objekte janë të rëndësishë së vecantë.
- NP-5 (Punime Ujesjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime ne ujesjellesa.
- N.S-1 (Punime për prishjen e ndërtimeve) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime prishje si te shtresave rrugore ashtu dhe te objekteve ekzistuese qe perfshihen ne zonene e projektit .
- N.S-2 (Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, etj)) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime në instalimin e paisjeve dhe lidhjen e objekteve me rrjetin e furnizimit me ujë.
- N.S-18 (Punime topogjeodezike) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime topografike ne instalimin e rrjetit te ujesjellesit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ‘‘Për prokurimin publik’’, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ‘‘Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’’, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 ‘‘Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi’’, i ndryshuar.

Licencat e mësipërme kërkohen në bazë të zërthimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve, në zbatim të VKM, Nr. 42, Datë 16.1.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Sipas lidhjes Nr.2 dhe lidhjes Nr.4.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë listë të personelit kryesor (drejtues teknik) , të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponentëve të saj.

Duhet te ketë si drejtues teknik të punësuar dhe të përfshirë në liçencën e shoqërisë minimalisht:

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi
- 1(një) Inxhinier Hidroteknik.
- 1(një) Inxhinier Mekanik
- 1(një) Inxhinier Elektrik
- 1(një) Inxhinier Gjeolog
- 1(një) Inxhinier Gjeodet/Topograf

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

CV-në e tyre, diplomat, kontratë individuale pune të noterizuar dhe liçencën personale të mbikqyrjes të tyre. Drejtuesit teknike të kërkuar më poshtë duhet të figurojnë në listepagesat e punonjësve të shoqërisë të siguruar për 3 muajt e fundit nga dita e hapjes së tenderit (formularet E-ig025/a.1)

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi (me eksperiencë pune në mbikqyrje i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, çertifikatën e pagesës të infrastrukturës rrugore dhe veprave të artit.)
- 1(një) Inxhinier Hidroteknik. (Mbikqyrësin per punimet e rrjetit te Kanalizimeve që duhet të jetë inxhinier hidroteknik me licence dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.)
- 1(një) Inxhinier Mekanik (Mbikqyrësin për punimet e sinjalistikës dhe sigurise rrugore që duhet të jetë inxhinier mekanik me eksperiencë pune në këtë fushë i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilesinë e punimeve.)
- 1(një) Inxhinier Elektrik (Mbikqyrësin per punimet elektrike që duhet të jetë inxhinier elektrik me licence dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.)
- 1(një) Inxhinier Gjeodet/Topograf (Mbikqyrësin per punimet topografike ne ndertimin e rrjetit te kanlizimeve ujerave te bardha, me licence dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.)
- 1(një) Inxhinier Gjeolog (Mbikqyrësin per punimet e gjeologjise duhet të jetë inxhinier gjeolog me eksperiencë pune i cili kontrollon punimet gjatë gërmimit.

Numri i punonjesve te kerkuar eshte vendosur ne raport me specialistet dhe pajisjet e kerkuara. Ky numer minimal punonjesih eshte i nevojshem dhe i domosdoshem per kryerjen e punimeve te objektit te prokurimit.

Shenim: Në përgatitjen e ofertes, ofertuesit duhet të respektojnë Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manulit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) me shkresën me Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017,” Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave” me qëllim respektimin nga operatorët ekonomikë të normave minimale (vlerave minimale të lejuara), të specifikuara në këtë vendim. Per vleren e fondit limit referohuni buletinit te APP per proceduren pune per objektin ne fjale. Ne rast se oferta eshte me e ulet se minimumi i percaktuar ne kete vendim ajo do te skualifikohet.

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.